

STRADIOTËT

Ushtarë shqiptarë në Itali (shek. XV-XIX)

Përmbajtja e lëndës

KREU I

USHTARË SHQIPTARË NË ITALI

*Në Marke e gjetkë. Albanët.
Në mbretërinë e Napolit dhe në Sicili
A ka ekzistuar ndonjëherë Demetrio Reres?
Pas Skënderbeut
Nga armët te shenjtëria*

KREU II

FIGURA E KALORËSIT LEVANTIN

*Stradioti: Picakapeleti
Luigi da Porto: një përvojë e jetuar
Shqiptarët e Matteo Bandellos
Letërsia greke*

KREU III

STRADIOTËT

*Shfaqja e stradiotëve
Pamja, armët e kuajt
Taktika
Luftimi “sipas mënyrës stradiote”
Përkorja e të varfërve
Një organizim i parregullt
Shqiptarë, grekë e dalmatë
Zagdarët*

KREU IV

HISTORI STRADIOTËSH SHQIPTARË

*Buzikët, “familja e parë e shqiptarëve”
Merkur Bua*

***Petat
Bokalët
Në kërkim të pronave feudale. Mathesët dhe
Bastat
Stradioti i fundit***

KREU V
MERCENARËT E FUNDIT

***Rënia e stradiotëve
Midis Venedikut, Napolit dhe Konstandin-
opojës
Në perandorinë osmane
I fundit është më fathumi***

KREU I

USHTARË SHQIPTARË NË ITALI

Shqiptarët nuk pritën pushtimin turk për të filluar emigrimin e tyre në Itali: prej kohësh ekzistonte një rrymë emigruese punëtorësh të shtresave të ulëta, ndërsa që të paktën nga gjysma e parë e shek. XV dokumentohet prania në Itali e ushtarëve profesionistë. Është fillimi i këtij fluksi ushtarësh shqiptarë, që do të bëhet përrua me suksesin evropian të stradiotëve, duke zgjatur deri në shek. XVIII, e në disa raste edhe në shek. XIX.

Mangësia e dokumenteve na lejon vetëm ta shquajmë këtë dukuri, dhe jo t'i bëjmë një përshkrim analitik. Kallëzuesi më i sigurt i saj jepet nga përhapja e mbiemrit Albanese apo Albanesi (ndonjëherë Albani), i cili në këtë shekull ende është me siguri një emër etnik, që shënon një emigrim të brezit të parë ose të shumtën të dytë. Ai që e mban, duket qartë që ka hyrë në një grup shoqëror ku të qenit shqiptar përbën një veçanti, të paktën po aq sa ngjyra e flokëve apo emri i babait: jo rastësisht ky mbiemër nuk u mbajt kurrë nga stradiotët – një trupë e përbërë kryesisht nga shqiptarë – ndërsa mbahej përkundrazi nga njerëz të armëve, oficerë këmbësorie ose ushtarë të thjeshtë.

Në Marke e gjetkë. Albanët

Market përbëjnë, në gjysmën e parë të shek. XIV, pikëmbërritjen kryesore të emigrimit ballkanik. Është krejt e natyrshme që ato të tërhiqnin jo vetëm fshatarë, zejtarë apo shërbëtorë shtëpiakë, po edhe mercenarë, aq më tepër që pikërisht në atë krahinë lulëzojnë dinasti që do ta ngrejë pasurinë e tyre pikërisht mbi condotte-t ushtarake.

E para ndër këto dinasti që vuri në shërbim ushtarët shqiptarë duket të ketë qenë ajo e Malatestave, e cila, e ndarë në degë të ndryshme që të gjitha të drejtuara nga prijës pak a shumë aventurierë, sundonte mbi qytete të ndryshme, që nga Rimini në Senigalia: por ja vlen të kujtohet rekrutimi i emigrantëve

shqiptarë, që ndodheshin në Jezi si fshatarë të thjeshtë, të cilët ajo komunë i përdori me sukses më 1461 (dhe nuk e dimë nëse bëhej fjalë për një rast të veçantë), pikërisht kundër trupave të Malatestave.¹

Prania e shqiptarëve në shërbim të Malatestave dokumentohet që nga vitet e para të shekullit, dhe nuk është fjala gjithmonë për ushtarë “të pakualifikuar” siç konsideroheshin atëherë këmbësorët. Një Grasso nga Shqipëria, në ato vite, ishte udhëheqës i 43 heshtave, domethënë i më se njëqind e njëzet kalorësve, që jo medoemos ishin bashkatdhetarët e tij: pra një personazh me njëfarë rëndësie, që kalon nëpër duar shuma të konsiderueshme parash. Shqiptarë të tjerë gjurmët e të cilëve ruhen në arkiva janë jo vetëm kalorës, por balestrierë, ose madje edhe zejtarë të specializuar për ndërtimin e pjesëve të topave. Për vite të tëra prania e tyre dëshmohej në qytete dhe nën komandantë të ndryshëm, ndërkohë që të tjerë, në të njëjtën krahinë, u shërbejnë zotërinjve krejt të tjerë, si Sforcave të Pezaros apo Frederikut të Montefeltros. Në kompaninë e madhe të Frederikut të Montefeltros, e cila në vitin 1482 mori pjesë në luftën e Ferrarës në shërbim të Estensëve, 260 kapitenët apo skuadërkomandantët janë të gjithë italianë, përveç tri shqiptarëve.²

Vetë Estensët, nga ana tjetër, kanë shqiptarë në shërbim të tyre: midis tyre kujtojmë një konstabël të këmbësorisë, që quhej Demetër, i cili disa vjet më vonë donte t’i merrte hakun një vëllait të vet, që kish mbetur i vrarë në një grindje midis ushtarësh, dhe për këtë arsye u shpall jashtë ligjit.³

Gjenden gjithandej shqiptarë, makar në një pozitë të varur, pra jo si ushtarë, por si shqytarë, ose thjesht shërbyes. Në Milano, një shqiptar në shërbim të Francesco Sforza-s, për të cilin nuk dimë asgjë, ndërton në Duomo një kamare elegante për nder të Virgjëreshës⁴. Në trupat e Papatit gjejmë gjithashtu shqiptarë që nga fillimi i shek. XV. Ende në vigjilje të plaçkitjes së vitit 1527, një prej shqiptarëve të paktë me qëndrim në Romë do të jetë një kapiten Giovanni, që banonte me familjen në lagjen Kampiteli⁵. Por natyrisht ata janë më të shumtë në trupat venedikase: duke lënë mënjanë stradiotët, që kërkojnë një shqyrtim më vete – dhe me të cilët do të njëjtësohet për më se gjysmë shekulli, gati për antonomazi, përfytyrimi luftëtar i shqiptarëve – mjafton të kujtojmë praninë ndër trupat venedikase të ushtarëve të shumtë, ose të kontestablëve të këmbësorisë që mbanin pikërisht mbiemrin Albanese, siç është rasti i një farë Jakobi, “plak e i mirë”, “trim e guximtar”, udhëheqës i 150, pastaj 200, pastaj i 350 vetëve, i cili më 1509 papritur e pakujtuar kalon në shërbim të mbretit të romanëve, dhe më pas bie rob i stradiotëve në Kastelfranko⁶. Veç kësaj të shumtë janë shqiptarët – edhe pse më pak se grekët e dalmatët – ndër detarët dhe shigjetarët e hipur nëpër galera; dhe nuk mungojnë lajmet për ndonjë rebelim të tyre, gjithsesi të mbytur në gjak⁷.

Ndër të gjitha familjet të cilat, meqenëse ushtronin zanatin e armëve, morën mbiemrin Albanese apo Albanesi, është njëra që, shumë kohë pas emigrimit, mundi të ngjitet në nivelet më të larta të hierarkive shoqërore: është fjala për atë familje Albani së cilës i përkisnin papa Klementi XI dhe kardinali Aleksandër që ishte koleksionisti më i madh i antikiteteve të shekullit XVIII dhe mbrojtës i Vinkelmanit. Albanët, qysh në vitin 1700, vit i zgjedhjes së Gian Francesco Albanit në fronin e papës, nuk kishin harruar as prejardhjen e tyre shqiptare – gjë që i çoi të refuzonin shërbimet e genealogjistëve të zellshëm, të gatshëm të vërtetonin prejardhjen e tyre nga mbretërit e Portugalisë apo të Hungarisë – as mbiemrin e tyre të parë, që ishte Lazi.

Sipas gojëdhanave familjare, Mikel Lazi paskësh ardhur në Itali në vitin 1464, pasi kishte luftuar me Skënderbeun; bijtë e tij Gjergji e Filipi (vdekur përkatësisht në 1520 dhe në 1508), të cilët qysh atëherë njiheshin rëndom me mbiemrin Albanesi, paskëshin qenë kapitenë në shërbim të Roberto Malatestës më parë, dhe më pas të dukëve të Urbinos. I dyti i shërbeu edhe Republikës venete. Më i njohuri nga të dy qe Filipi, njëri prej të paktëve kapitenë të trupave shqiptare. Kur vdiq, në Ravenë, komandonte plot 400 kuaj (nga tre kuaj për heshtar: pra më se 130 heshtarë). Për të nuk mbahen mend ngjarje të bujshme luftarake, por Sanuto e kujton si një kapiten “shumë besnik, trim dhe zulmëmadh; e paguante gjithë kompaninë e tij me para, dhe jo me mall, dhe kur vdiq iu gjetën vetëm gjashtë dukatë”⁸. Dimë edhe që bëri marrëveshje për dorëzimin e disa fortesave armike, gjë që tregon se nuk ishte vetëm luftëtar, por edhe një negociator i shkathët.

Altobello, biri i Gjergjit, e ndryshoi përsëri mbiemrin e familjes në Albani.

